

Mund të përfshihen kompanitë publike ose private (ndërmarrjet e vogla, të mesme ose të mëdha (përfshirë ndërmarrjet sociale). Prandaj, ky veprim synon kryesisht shoqatat, OJQ-të dhe në përgjithësi organizatat jofitimprurëse, ku organizatat fitimprurëse mund të përfshihen nëse është demonstruar një vlerë e qartë e shtuar për projektin. Megjithatë, në një objektivi të ndërtimit të kapaciteteve, detyrat e koordinimit duhet të kufizohen në organizatat jofitimprurëse.

Ku të aplikoni?

Në Agjencinë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (AEEAK).

Kur të aplikoni?

Aplikantët duhet të dorëzojnë aplikacionin e tyre për grant brenda afatit të shpallur brenda thirrjes së vazhdueshme për propozime Erasmus+.

Për më shumë informacion ju lutemi konsultoni lidhjen e mëposhtme: <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/calls/capacity-building-in-the-field-of-youth>

Ndërtimi i kapaciteteve
në fushën e
RINISË

Erasmus+

ec.europa.eu/erasmus-plus
eacea.ec.europa.eu

 facebook.com/EUErasmusPlusProgramme
 [EUErasmusPlus](https://twitter.com/EUErasmusPlus)

Zyra e Erasmus+ në Kosovë

 office@erasmuspluskosovo.org
 www.erasmuspluskosovo.org
 facebook.com/erasmuspluskosovo
 <https://www.linkedin.com/company/kosovo-erasmus-office/>



Mbështetur nga:  EUROPE HOUSE



Ndërtimi i kapaciteteve
në fushën e
RINISË



Erasmus+
Enriching lives, opening minds.



Erasmus+
Enriching lives, opening minds.



Projektet e ngritjes së kapaciteteve janë projekte bashkëpunimi ndërkombëtar të bazuara në partneritete shumëpalëshe ndërmjet organizatave aktive në fushën e të rinjve në Program dhe vendeve të treta që nuk janë të lidhura me Programin. Ato synojnë të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar dhe dialogun e politikave në fushën e të rinjve dhe të të mësuarit joformal, si nxitje e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mirëqenies së organizatave rinore dhe të rinjve.



Fushat tematike / Objektivat specifike

Propozimet duhet të fokusohen në një ose më shumë nga fushat tematike të mëposhtme:

- Pjesëmarrja politike dhe dialogu me vendimmarrësit;
- përfshirja e të rinjve me më pak mundësi;
- demokracia, sundimi i ligjit dhe vlerat;
- fuqizimi / angazhimi / punësimi i të rinjve;
- paqja dhe pajtimi pas konfliktit;
- mjedisi dhe klima;
- anti-diskriminimi dhe barazia gjinore;
- aftësi dixhitale dhe sipërmarrëse.

Kush mund të aplikoj?

Organizatat e mëposhtme mund të përfshihen si koordinatorë:

- OJQ-të (duke përfshirë OJQ-të rinore evropiane dhe Këshillat Rinorë kombëtarë) që punojnë në fushën e Rinisë;
- Autoritetet publike në nivel lokal, rajonal ose kombëtar.

Organizata aplikon në emër të të gjitha organizatave pjesëmarrëse të përfshira në projekt dhe duhet të jetë e themeluar dhe e vendosur ligjërish në një Shtet Anëtar të BE-së ose në një vend të tretë të lidhur me Programin ose në një vend të tretë që nuk është i lidhur me Programin, i cili është i përshtatshëm për pjesëmarrje në këtë veprim.

Cilat lloje të organizatave kanë të drejtë të marrin pjesë në projekt?

Çdo organizatë, publike ose private, me entitetet e saja të lidhura (nëse ka), që punon me ose për të rinjtë jashtë mjediseve formale të krijuara në një Shtet Anëtar të BE-së ose në një vend të tretë të lidhur me Programin, ose në një vend të tretë që nuk është i lidhur me Programin nga rajonet 1 dhe 3. Organizata të tilla, për shembull, mund të jenë:

- Një organizatë jofitimprurëse, shoqatë, OJQ (përfshirë OJQ-të rinore evropiane);
- një Këshill kombëtar rinor;
- një autoritet publik në nivel lokal, rajonal ose kombëtar;
- një institucion arsimor ose kërkimor;
- një fondacion.